



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – URED PRESEDNIKA

KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

Shtojca 1

Rekomandimet e takimit të dytë **3 korrik 2012, Prishtinë**

1. Të ketë fokusim të shtuar në përmbushjen e kriterëve të udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, sidomos të bllokut të tretë, ku pritet zbatim i reformave dhe rezultate të matshme në rendin dhe sigurinë publike, dhe në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.
2. Përmirësimi i koordinimit ndërmjet agjencive shtetërore për zbatimin e ligjit. Kjo kërkon jo vetëm hartimin e strategjive dhe ligjeve, por zbatimin dhe buxhetimin dhe mbështetjen me strukturë administrative dhe burime humane adekuate.
3. Ndryshimin e praktikave gjatë paraqitjes së projektligjeve apo dispozitave në Kuvend që ato të jenë të saktësuara me emra, dhe jo vetëm me numra, siç është praktika aktuale.
4. Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian të trajtojë çështjen e bashkërendimit ndër-institucional.
5. Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian të kërkojë nga secili institucion planet e veprimit për secilin kusht që gjendet në udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave.
6. Të ketë fokus më të madh në afirmimin e të arriturave të vendit gjatë përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në agjendën evropiane dhe procesin e liberalizimit të vizave.

7. Ftohet Ministria e Integritit Evropian që të vazhdojë me takimet e Task Forcës dhe tavolinave të rrumbullakëta me qëllim të përfundimit të Strategjisë për Integrim Evropian. Pas finalizimit të Strategjisë, Këshilli do të shqyrtojë dhe miratojë Strategjinë.